



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 59/12
Prishtinë, më 17.04.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Muhamet Mustafa, Albana Fetoshi, Duda Balje dhe Xhevdet Neziraj.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Sylejman Shaqiri Drejtor i Përgjithshëm i RTK-së, Bujar Spahiu Drejtor Financiar i RTK-së, Bedri Mecini dhe Dafina Hasanmetaj nga Agjensioni Kundër Korrupsionit, Ismet Krasniqi Sekretar i Kuvendit, Alexander Beetz, Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga OSCE, KDI, Kushtrim Aliu (praktikant).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Raporti financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2011;**
3. **Shqyrtimi i kërkesës së Radiotelevizionit të Kosovës për mbulimin e shpenzimeve të Auditimit të performancës së RTK-së;**
4. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2011;**
5. **Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2011;**
6. **Shqyrtimi i kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit për caktimin e pagave për zëvendësit e Avokatit të Popullit;**
7. **Shqyrtimi i ProjektKodit Penal i Republikës së Kosovës me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion;**
8. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
9. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, njoftoi se jeni të njoftuar në formë elektronike për ndryshimin e rendit të ditës: janë shtuar dy pika Shqyrtimi i ProjektKodit Penal i Republikës së Kosovës me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion dhe Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, propozoi që rendi ditës të plotësohet me këto plotësime.

Rendi i ditës miratohet njëzëri.

2. Shqyrtimi i Raporti financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2011

Kryetarja, RTK ka sjellur raportin e Punës dhe Raportin Financiar Vjetor, ku i kemi të prezantuar shënimet për buxhetin e shpenzuara për vitin 2011 dhe krahasimet me vitin 2010.

Sylejman Shaqiri, në vitin 2011 RTK ka hyrë me një paqartësi në çështjen e financimit, mosmiratimi i ligjit për transmetuesin publik 2010 e ka lënë RTK-në pa zgjidhjen e çështjes së financimit afatgjatë dhe të qëndrueshëm, dhe ka shkaktuar probleme për RTK-në. Për tre muajt e parë kemi marrë mjete nga buxheti i Kosovës në nivel të viti 2010, ndërsa pas miratimit të ligjit të buxhetit për vitin 2011 na është ndarë buxhet dukshëm më i vogël dhe si rezultat jemi detyruar që të hyjmë në deficit për të mbuluar shpenzimet. Kjo është arsyeja e vështirësive segmentit financiar të funksionimit të RTK-së.

Bujar Spahiu, prezantoi shkurtimisht buxhetin duke njoftuar se Buxheti i 2011 ne krahasim me atë të vitit 2010 ka qenë më i shkurtër për 2 milion e gjysmë. Pasqyrat janë të paraqitura në baza akruale dhe në pasqyrën e të ardhurave e kemi të paraqitur deficitin, si dhe raporti përmban shpenzimet sipas kategorive ekonomike. Po ashtu kemi pasur auditimin nga Auditori Gjeneral dhe jemi në pritje të raportit.

Kryetarja, interesimi i të gjithë anëtarëve të komisionit është deficitin e RTK-së, sepse në raportet qoftë vjetore apo periodike shihet që janë shpenzuar më shumë mjete se ato që ka pasur në dispozicion RTK-ja. Na shpjegoni si keni arritur deri tek rritja e këtij deficitin, a është përcjellur deficitin edhe ne vitin 2010 dhe 2011 dhe si e parashihni mbulimin e këtij deficitin?

Sylejman Shaqiri, lidhur me problemet e deficitit njoftoi se gjeneza e kësaj situate është që nga tetori i vitit 2009, sepse deri në janar të vitit 2010, RTK-ja nuk u financua nga asnjë burim. Vetëm në muajin shkurt Kuvendi i Kosovës e miratoi një ndërhyrje buxhetore 9 milion e 600 mijë euro. Ne kemi ekonomizuar gjatë vitit 2010 dhe kemi arritur ta ruajmë dinamikën e shlyerjes së obligimeve dhe kur kemi hyrë në vitin 2011 jashtë të gjitha parashikimeve është bërë një shkurtim i buxhetit për 2 milion e 600 mijë dhe ne jemi përpjekur të ekonomizojmë duke i zvogëluar shpenzimet. Për ta përfunduar vitin 2012 me një bilanc zero ne do ta bëjmë një kërkesë për rishikim të buxhetit ose do të presim hyrjen e ligjit në fuqi dhe do të shohim cilat do të jenë reflektimet e dispozitave të reja ligjore me të cilat do të rregullohet edhe financimi i RTK-së.

Sali Asllani, theksoi se jemi solidarizuar me kërkesat e RTK-së me bindjen që jeni në gjendje të keqe financiare për shkak se keni pasur restriksione buxhetore nga viti 2010 në 2011. Diqka që më shqetësoi është se në këtë restriksion buxhetor kemi rritje të pagave 300 mijë më tepër. Si reflektoi kjo? Dua të jap vërejtje në këtë aspekt. Çështja tjetër është pse janë bërë restriksione në të drejtat e sportit në vitin, si qëndron puna ?

Bujar Spahiu, njoftoi se tek rritja e pagave shkaktar kryesor janë obligimet që i kemi ndaj kontratave kolektive d.m.th shujta që kemi qenë të obliguar t'ia paguajmë punëtorëve dhe obligimi ligjor për pagat e dy

zëvendës drejtorëve. Tek sporti zvogëlimi është për shkak se kur lidhet kontrata për shembull për ligën e kampionëve dinamikën e pagesave na e cakton kontraktuesi. Fillimisht e paguajmë këstin më të madh pastaj shkon duke u zvogëluar.

Sylejman Shaqiri, në çështjen e ngritur për pagat, njoftoi se kemi pasur një numër të madh të punëtorëve që kanë punuar me kontrata mbi vepra dhe kanë qenë me afate të stërzgjatura. Në vitin 2007 në RTK janë miratuar aktet normative dhe një numër i konsiderueshëm i punëtorëve nga kontrata e rregullt kanë kaluar mbi vepër. Me miratimin edhe të ligjit të punës punëtorët që punojnë 7 ditë në javë dhe gjatë vitit e kemi pasur si politikë të mos i mbajmë me kontrata mbi vepër sepse kanë qenë punëtorë të dëmtuar. Kjo ka shkaktuar mes tjerash ngritjen e pagave.

Hasime Krasniqi, unë mendoj që drejtori duhet të ketë parasysh që të bëjë zvogëlimin e shpenzimeve me qëllim që të zvogëlohet ky deficit kaq i lartë e jo të drejtohet vetëm tek buxheti për mjete shtesë. Ne jemi të mbështesim kontratën kolektive mirëpo duke u bazuar në fushat financiare të cilat i ka ndërmarrja apo organizata. Janë për t'u habitur pagat e punëtorëve të rregullt, pagat me kontrata një vjeçare, pagat e kontraktuara. Unë mendoj se të gjitha këto duhet të përfshihen në pagat e rregullta. Të merrni si vërejtje nga ana e jonë që të hulumtojnë aty ku është e mundur të kursehet. Po ashtu shpenzimet e ujit, telefonit, derivateve janë shumë të mëdha. Të keni parasysh zvogëlimin e këtyre shpenzimeve.

Hykmete Bajrami, në raportin financiar obligimet ndaj palëve të treta dhe obligimet në përgjithësi janë të fragmentuara në disa pjesë. Pyeti sa janë obligimet e pa paguara të RTK-së në total?

Bujar Spahiu, në përgjigjen e folëses së fundit, njoftoi se totali i detyrimeve të RTK-së për vitin 2011 janë 2 milion e 686 mijë dhe një pjesë e detyrimeve janë zvogëluar për shkak të kursimeve që i kemi bërë. Por megjithatë janë disa shpenzime të shtrenjta, siç është rasti i transmetimit të kampionatit evropian dhe botëror që jemi të obliguar me ligj të transmetojmë dhe këstet e pagesave kanë filluar qysh tani. Po ashtu janë disa obligime ligjore të cilave po duhet më i përmbush, si rast i shpenzimeve të satelitit të cilat janë shumë të larta. Obligim ligjor për transmetimit në gjuhët e minoriteteve. Shpenzimet e telefonatave ngarkohen si rezultat i punës së Radiokosovës dhe Radio Bluesky ku 80% puna e tyre bazohet në telefonata. Sa i përket derivateve të naftës, veturat dalin çdo ditë në teren, janë të amortizuara me vite të tera nuk kemi mbërri të bëjmë riparimin ose ndryshimin e tyre dhe sigurisht shpenzojnë shumë më tepër se që duhet. Me agjensionin e marketingut është ndërprerë kontrata më 2010, i cili ka punu më provizion dhe ka sjell shumë më tepër të hyra se sa kur e kemi kriju sektorin tonë brenda për brenda marketingut.

Latif Gashi, sa i përket deficitit e keni prezantuar deficitin për vitin 2011 dhe nga raporti shifet se deficitin është akumuluar edhe në 2010, e që në total arrin 4.699.000, a është fjala për deficitin e krijuar në vitin 2011 apo keni deficit edhe në vitin 2010? Si e shpjegoni tejkalimin e buxhetit për mallra dhe shërbime? edhe si mendoni më menagjue RTK-në në këtë mënyrë menaxhimi?

Bujar Spahiu, sqaroi se deficitin total për vitin 2011 është 2.500.000 euro dhe në total arrin shumën prej 3.524.000 euro, përfshirë edhe vitet paraprake. Obligimi nuk nënkupton deficit sepse obligimi nënkupton edhe amortizimin kategori e cila patjetër duhet të paraqitet në libra por në realitet nuk është obligim të cilin duhet më pague më para. Sa i përket shpenzimeve për mallra dhe shërbime në fillim të vitit 2011 në janar neve na u kanë derdh mjetet për tre mujorin e parë në nivel të buxhetit të vitit 2010, dhe ne kemi planifikuar buxhetin e vitit 2011 në shumën e buxhetit 2010 të gjitha kontratat që janë bërë në lartësi prej buxhetit prej 12.000.000. Ndërkaq buxheti i RTK-së për vitin 2011 është miratuar në vlerë prej 7.900.000 eurove, dmth i kemi marr më pak se 2010.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni me dhjetë vota Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Muhamet Mustafa, Duda Balje, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj) një Abstenim (Sali Asllanaj) dhe asnjë Kundër nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2011.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Radiotelevizionit të Kosovës për mbulimin e shpenzimeve të Auditimit të performancës së RTK-së

Kryetarja, theksoi se anëtarët e komisionit janë të njoftuar me kërkesën e Radiotelevizionit të Kosovës për mbulimin e shpenzimeve të auditimit të performancës së RTK-së. Ne ndëgjuam nga drejtori financiar që është bërë një auditim i rregullsisë nga auditori i përgjithshëm ndaj këtij mediumi, megjithatë auditimi i performancës le të kuptohet se si janë shpenzuar mjetet dhe sa është efektshmëria të këtyre mjeteve? Me qenë se për këtë qëllim ka qenë i krijuar edhe grupi punues, ia kalojë fjalën udhëheqësit të grupit Naser Osmanit.

Naser Osmani, theksoi se zgjedhja më e mirë e mundshme do të ishte që si komision, t'i rekomandojmë që Kryesisë së Kuvendit, që Kryesia e Kuvendit t'i drejtohet auditorit të përgjithshëm të kryej auditimin e performancës së Radiotelevizionit të Kosovës pasi që ne nuk e kemi atë të drejtë ti rekomandojmë direkt auditorit. Auditori Gjeneral nëse nuk e ka planifikuar këtë auditim në buxhetin vjetor, mund t'i drejtohet Kuvendit për qeshjen e mjeteve shtesë

Xhevdet Neziraj, mbështeti rekomandimin që Kryesia e Kuvendit, të kërkojë nga Auditori i Përgjithshëm të kryej auditimin e performancës së RTK-së, pasi që edhe në kuadër të fushëveprimtarisë së këtij institucioni dhe këtë duhet ta bëjë pa pasur nevojë për mjete shtesë.

Kryetarja, vlerësoi se auditori përveç auditimeve të rregullsisë, në bazë të ligjit bënë edhe auditime të performancës për institucionet publike dhe auditimi i performancës së RTK-së hynë në kuadër të fushëveprimtarisë së tij ligjore dhe propozojë që Kryesisë së Kuvendit si komision, t'i rekomandojmë që të kërkojë nga Auditori i përgjithshëm, të bëjë auditimin e performancës së radiotelevizionit të Kosovës.

Albana Fetoshi, pyeti a nuk ka mundësi që RTK-ja të mbulojë shpenzimet auditimit të performancës brenda buxhetit të vet?

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni me dhjetë vota Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Muhamet Mustafa, Duda Balje dhe Xhevdet Neziraj) një Abstenim (Albana Fetoshi) dhe asnjë Kundër nxori këtë

REKOMANDIM

Kryesia e Kuvendit në pajtim me nenin 3.7 të Ligjit nr.03/075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Zyrës të Kosovës, të kërkojë nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, të kryej auditimin e performancës apo mbarëvajtjes së Radiotelevizionit të Kosovës.

4. Shqyrtimi i raportit financiar të agjencisë kundër korrupsionit për vitin 2011

Bedri Mecini, raporti për shpenzimet e buxhetit të AKK-së për vitin 2011 sipas kategorive ekonomike në bazë të të dhënave të përfshira në raport. Sa i përket shpenzimeve kapitale, ka qenë i planifikuar një projekt kapital “Krijimi sistemit të teknologjisë informative” në vlerë prej 30.000€, por megjithëse ky projekt është përfunduar në vitin 2010 dhe me buxhetin e atij viti, këto mjete i kemi deklaruar të Ministria e Financave si të lira. Mos realizimi i buxhetit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve siç është planifikuar, është si pasojë e disa lëvizjeve të zyrtarëve. Për vitin 2010 ka qenë 98.9% në këtë kategori. Ndërsa të mallrat dhe shërbimet i kemi deklaruar mjete të lira afër 90.000 euro, të cilat së bashku me mjetet dhe totali mjete të lira të deklaruar dhe të marrura nga qeveria më një vendim është 131.980 euro.

Kryetarja, vërejtja ime është tek projekti kapital, mjetet e për të cilin nuk janë shpenzuar. Po ashtu raporti nuk është i detalizuar, do të duhej të prezantoni planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve, dhe të bëni krahasimet më vitet e kaluara. Edhe pse bëhet presion për ndarje të mjeteve buxhetore, nga raportet shifet se në secilën kategori ka teprice të tyre. Në përgjithësi, ajo qfarë shohim nga raportet financiare të të gjitha agjencioneve të pavarura që raportojnë në Kuvend, nuk kemi raporte të detalizuara, nuk prezantohen si kërkohet planifikimi dhe realizimi i buxhetit, krahasimi me vitin e kaluar dhe detalizimi i nënkategorive ekonomike.

Hykmete Bajrami, ndarja e raporteve në shqyrtim në disa komisione, na lënë shumë të mangët dhe është paradoksale kur kritikojmë këto agjencione për shpenzimet, siq është rasti të ky agjencion ku kemi shpenzime racionale, shumë pak shpenzime të karburanteve, të telefonit dhe nëse janë kthyer mjetet, janë kthyer në buxhetin e Kosovës dhe e kanë ndihmuar rezervën e buxhetore, ndërsa kemi agjencione tejkalojnë shpenzimet, sidomos në tre mujorin e fundit dhe paraqesin deficit dhe kërkojnë mjete shtesë. Megjithatë pajtohem me vërejtjet për një raport më të detalizuar.

Sali Asllanaj, përkundër vërejtjeve në përgatitjen teknike të raportit, mendojë që është për t’u vlerësuar mosshpenzimi i mjeteve dhe kthimi i tyre në buxhetin e Kosovës.

Latif Gashi, pajtohem me kryetaren, se mungon krahasimi i shpenzimeve në raport më buxhetin e lejuar pastaj mjetet e planifikuara dhe shprehja e tyre në përqindje dhe me paraqitjen e këtyre informatave, raporti kishte me qenë shumë më i mirë.

Naser Osmani, pavarësisht shumave të shpenzuar, vlersimet e shpenzimeve, bëhen në krahasim me punën e tyre. Por vlerësimin e shpenzimeve nuk mund të bëjmë në këtë formë ashtu siq theksoi edhe Hykmetja.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit miratimin e raportit financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2011.

5. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2011

Ismet Krasniqi, raportoi se shpenzim total të buxhetit të Kuvendit është rreth 95.1% dhe më pas raportoi për shpenzimet sipas kategorive ekonomike. Theksoi se pika më e dobët që vazhdon është në investimet kapitale që është 53.41%. Të pjesa e materialit është edhe një pozicion tjetër që në fund vitit të kaluar e kemi nënshkruar dhe kontrata sille rreth 17.5%, dhe shpenzimet kapitale në total kapin një vlerë rreth 75%. Problemi më i madhë në këtë kategori, vazhdon të jetë “Qendra protokolare Villa Gërmia”.

Kryetarja, theksoi se nuk është vetëm viti 2011 që nuk janë realizuar investimet në kapitale, por është një dukuri që po përcillet nga viti në vit dhe shpesh herë kemi kërkesa edhe për ndërrimin e projekteve kapitaleve gjatë vitit. Ne kemi shqyrtuar KASH-in e Kuvendit për vitin 2013-2015 dhe i kemi rekomanduar Kryesisë së Kuvendit që ta merr një vendim përfundimtar në lidhje me projektin Vila Gërmia dhe pa u miratuar buxheti i vitet të ardhshëm do të duhet jemi të njoftuar më vendimet që do ta merr kryesia.

Salih Asllanaj, pyeti a keni pas mjete të mjaftueshme për të kryet punën dhe me qenë funksional, kur dihet se në vitin 2012 për Kuvendin e Kosovës, ka pasur zvogëlim të buxhetit?

Ismet Krasniqi, theksoi se në vitin 2011 kemi shpenzuar vetëm 2200 para kesh. Sa i përket vitit 2012 komisioni është në dijeni që kemi pas një shkurtim të buxhetit por do të ketë një mirëkuptim për këtë vite dhe kërkesat njëfarë mënyre janë shkurtuar dhe do të paraqesim kërkesat shtesë me rishikim dhe besojmë në përkrahjen nga komisioni, që të mund t'i përmbyllim obligimet e parapara dhe kërkuara për këtë vit. Kemi mbështetje për hapjen e zyrave të deputetëve nga shtatë qendra është një kërkesë permanente të cilën vetë deputetet takimet që kanë më partnerët ndërkombëtar e mbështesin si iniciativë, ndërsa mjetet nuk ndahen në të njëjtën kohë jemi në presion përse nuk ka zyrë të deputetëve nëpër shtatë qendra.

Naser Osmani, theksoi se projekti kapital Vila Gërmia, do të duhej të zgjidhej përfundimisht nga Kryesia, në të kundërtën nëse kjo nuk ndodh, në buxhetin e vitit të ardhshëm do të propozojmë që për këtë projekt të ndahet vetëm një euro, sa për të mbetur i tillë dhe të mos mbetet hapësirë për transfer të mjeteve në shpenzimet tjera.

Latif Gashi, sa i përket projektit kapital Vila Gërmia, do të duhej sqaruar statusit i tij, kontesti gjyqësor dhe mëpastaj të merret një vendim politik përfundimtar.

Kryetarja, gjithashtu mbështeti konstatimin e z. Osmani për projektin kapital Vila Gërmia, dhe në rast se Kryesia nuk vendos për zgjidhjen përfundimtare, ne si komision do të propozojmë që të ndahen vetëm një euro, vetëm që të mbetet si pozicion.

6. Shqyrtimi i kërkesës së institucionit të avokatit të popullit për caktimin e pagave për zëvendësit e avokatit të popullit

Kryetarja, njoftoi se me rastin e shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit të Kosovës dhe shqyrtimit të kërkesës së avokatit të popullit për vitin 2011, e kemi miratuar buxhetin edhe për pesë zëvendës avokatët e popullit, katër kanë qenë të paraparë më buxheti kurse për një zëvendës avokat i cili është shtuar më ligjin për zyrën e institucionit të avokatit në i kemi shtuar mjetet për këtë institucion. Nga kërkesa që kemi marrë jemi njoftuar nga zëvendësit e avokatit të popullit që pagat nuk janë ekzekutuar siç janë planifikuar. Në mungesë të zgjidhjes ligjore, ka kërkuar që për caktimin e pagës së avokatit të popullit dhe zëvendësve të tij, t'i referohemi një Rregullore së UNMIK-ut e cila është shfuqizuar me ligjin aktual për avokatin e popullit. kërkesa për rritje të pagave në nivel të gjyqtarëve të gjykatës supreme siç ka qenë e përcaktuare me Rregulloren e UNMIK-ut nuk ka pasur mundësi të ekzekutohet prandaj ne kemi kërkuar një këshillë ligjore edhe nga departamenti ligjor i Kuvendit, dhe këshilla e ofruar, sugjeron se vendimi për caktimin e pagës së avokatit të popullit dhe zëvendësve të tij, nuk mund t'i referohet dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut 2006/6, për institucionin e avokatit të popullit, pasi që kjo rregullore është shfuqizuar me ligjin nr. 03/L-195 për avokatin e popullit. Ligji aktual për avokatin e popullit ka të përcaktuar që niveli i pagës së avokatit të popullit dhe zëvendësve të tij do të rregullohet më ligjin për paga të zyrtarëve të lartë publik i cili ende nuk është procedura për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Megjithatë ne me rastin e shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit të Kosovës, kemi ndarë mjete shtesë ne emër të rritjes së pagës së avokatit të popullit

dhe pesë zëvendësve të tij prej 30% dhe nuk jemi në dijeni pse nuk janë ekzekutuar ashtu siç pretendojnë zëvendësavokatët në atë shumë që kanë qenë të ndara.

Basri Berisha, njoftoi për zgjedhjen e pesë zëvendës avokatëve nga Kuvendit dhe me problemet që kanë pasur në marrjen e pagave. Gjithashtu theksoi se me qenë se ligji aktual nuk duhet e definon çështjen e pagave për avokatin e popullit dhe zëvendësve të tij, dhe thirret në një ligj që nuk ekziston, dhe juridikisht dihet që deri sa nuk hynë në fuqi një ligj i ri, zbatohet dispozita e ligjit të vjetër, që në këtë rast do të thotë Rregullorja e UNMIK-ut në çështjen e pagave.

Kryetarja, në bazë të rritjes që ka ndodhur në vitin 2011, është paraparë që paga a avokatit të popullit të jetë 837.98 euro, ndërsa për pesë zëvendës avokatët e popullit 782.10 euro. Pyeti zëvendësavokatin e popullit, a mundesh të na tregoni a janë ekzekutuar pagat në shumën të njëjta të miratuara me buxhetin e vitit 2011?

Naser Osmani, theksoi se kur është çështja e pagës dhe inversit personal të avokatëve të popullit dhe zëvendës avokatit të popullit kërkojnë të zbatohet Rregullorja e UNMIK-ut e unë nuk mundemi të referohemi në Rregulloren që më ligjet e reja janë shfuqizuar.

Basri Berisha, njoftoi se janë proceduar pagat për zëvendësavokatët për tre muajt e parë të vitit 2012 në nivelin e përmendur nga kryetarja. Punën si zëvendës avokat të popullit e kemi filluar në nëntor të vitit 2011 dhe për dy muajt e fundit të vitit të kaluar nuk kemi marrur paga.

Latif Gashi, kërkoi nga zëvendës avokat të përgjigjet konkretisht a është zbatuar vendimi i Kuvendit për ekzekutimin e pagave? Dhe pyeti sa punëtor i ka Institucioni i Avokatit të Popullit?

Kryetarja, në materialin që na e kanë dërguar zëvendësit e avokatit të popullit, thuhet që nuk po ekzekutohen paga për dy zëvendës avokatët e popullit dhe për tre zëvendësit tjerë nuk po ekzekutohet fare. Pyetja konkrete është a janë ekzekutuar pagat e zëvendës avokatëve të popullit në nivelin që ka vendosur Kuvendi me ligjin e buxhetit për 2011 dhe me ligjin e buxhetit të vitit 2012, një sqarim për këtë?

Sali Asllanaj, mendojë që avokati i popullit dhe zëvendësve të tij, nuk janë fajtor për problemin ligjor në përcaktimin e pagave të tyre. Kemi të bëjmë me një institucion të rëndësishëm kushtetues. Për atë që jam në njohuri unë, në mungesë të ligjit ekzistues apo zgjidhjes ligjore do të duhej të referohemi ligjeve paraprake. Sa i përket Rregulloreve të UNMIK-ut, nuk është ndonjë çudi, kur dihet se ende kemi dhe zbatohen Rregullore të tilla të UNMIK-ut.

Albana Fetoshi, theksoi se Kuvendi është ai i cili i miraton ligjet, më sa kuptova ligji që rregullon pagat e avokatit të popullit dhe zëvendësve të tij, nuk është proceduar ende në Kuvend dhe përderisa ka vakum ligjor, mendojë që kuvendi duhet me gjejë një zgjidhje për këtë problem.

Basri Berisha, njoftoi se punëtor në zyrën e avokatit të popullit janë 44 (përfshirë avokatin dhe zëvendësit e tij). Njoftimin që na ardhur nga drejtori ekzekutiv, na është thënë se paga e re e propozuar nuk është në njëfarë mënyrë ligjor. Dhe asnjëherë nuk është paguar paga e zëvendës avokatit të popullit sipas rregullores 2006/6 është zbatu atëherë kur ka qenë ajo në fuqi. Dhe paga është rritur në 30% kur iu kanë rrit edhe shërbimit civil dhe krahasimi nuk është në rregull.

Kryetarja, propozojë që Komisioni t'i rekomandojë Kryesisë së Kuvendit, që të kërkojë nga Qeveria të bëjë ekzekutimin e për dy muajt e vitit 2011 për dy zëvendësit e tij të cilët nuk janë paguar fare dhe nëse ka

pas pagesë të pjesshme nga ajo që është caktuar më buxhetin e vitit 2011 dhe 2012 edhe për tre zëvendësit e avokatit të tjerë atëherë të behët sipas ligjit për buxhetit.

Muhamet Mustafa, duke parë problemin me pagat e përfaqësuesve të organeve të pavarura të zgjedhur si komision, propozoi që pjesë e rekomandimit që do t'i dërgohet Kryesisë, të jetë që të kërkohej nga Qeveria të përshpejtojë procedimin e Ligjit për pagat e zyrtarëve të lartë në Kuvend.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

- I. Kryesia e Kuvendit të kërkojë nga Qeveria e Kosovës që të ekzekutojë pagat për pesë zëvendësavokatët e popullit në nivelin e pagës të përcaktuar me Ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012.
- II. Kryesia e Kuvendit t'i rekomandojë Qeverisë, për përshpejtimin e procedimit të Ligjit për pagat e zyrtarëve të lartë publik, për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

7. Shqyrtimi i ProjektKodit Penal i Republikës së Kosovës me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion

Kryetarja, theksoi se në bazë të analizës së bërë projektligjit, shifet se nuk përmban kosto shtesë buxhetore, i tillë është edhe opinioni i Ministrisë së Financave. Gjithashtu as amendamente e propozuara nga komisioni funksional nuk është vërejtur se përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetarja, theksoi se në bazë të analizës së bërë projektligjit, shifet se nuk përmban kosto shtesë buxhetore, i tillë është edhe opinioni i Ministrisë së Financave. Gjithashtu as amendamente e propozuara nga komisioni funksional nuk është vërejtur se përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni me nëntë vota Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Duda Balje dhe Xhevdet Neziraj) dy Abstenime (Muhamet Mustafa dhe Albana Fetoshi) dhe asnjë Kundër nxori këtë

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

9. Të ndryshme

Në të ndryshme u bisedua për përgatitjen që janë bërë për fillimin e mbikëqyerjes së zbatimit të Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Është hartuar plani veprimit dhe është

parapare që të fillohet raportimin e Ministrit të Financave në Komision, që u vendos të ndodh të mërkurën e ardhshme dhe pastaj grupi punues të fillojë punën e monitorimit në teren.

Mbledhja përfundoi: 13:15

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj